

Miratoi:

Kryetari

Z. ARTUR BUSHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE


BASHKIA KRUJE

OBJEKTI: "REHABILITIMI I PRITES LUMORE, MURQINE, FUSHE KRUJE"

SPECIFIKIME TEKNIKE

PERGATITI:


"ENGINEERING CONSULTING GROUP" SHPK



TIRANE 2024


ENGINEERING CONSULTING GROUP

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob: +355 69 40 98 814 NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tirane; e-mail: ecgroup20@gmail.com




Permbajtja

1.	TE PERGJITHSHME.....	4
1.1	Hyrje	4
1.2	Vendndodhja dhe hapësira e vendit të punimeve.....	4
1.3	Specifikimet.....	4
1.3.1	Specifikimet Nderkombetare	4
1.3.2	Specifikimet Standarde	5
1.4	Njesite	5
1.5	Zevendesimet.....	5
1.6	Grafiku dhe metodologjia e punimeve	6
1.7	Mirembajtja e rruges dhe ndertimeve ekzistuese.....	7
1.8	Mobilizimi (Ngritja e kantierit).....	7
1.9	Hyrja në kantier dhe në sheshin e ndertimit	8
1.10	Furnizimi me ujë gjatë zbatimit të punimeve	8
1.11	Furnizimi me energji elektrike.....	8
1.12	Moti i pafavorshëm.....	9
1.13	Transport i punonjësve	9
1.14	Marrja në dorezim	9
1.15	Piketimi dhe fotografimi i punimeve.....	9
1.16	Mbrojtja e punimeve, ambientit dhe publikut	10
1.17	Tabela e Punimeve.....	11
1.18	Transporti dhe magazinimi i materialeve.....	11
1.19	Ditari i kantierit dhe Librezat e masave	12
1.20	Takimet progresive të punës	12
1.21	Standardet e zbatimit	13
1.22	Ndihma e shpejte.....	13
1.23	Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik	13
1.24	Karrierat e materialeve inerte dhe gureve	13
1.24.1	Karriera e inerteve për prodhimin e betoneve.....	14
1.25	Çmontimi i kantierit.....	14



1.26	Azhornimi perfundimtar, Dorezimi dhe Kolaudimi i punimeve.....	14
2.	PUNIME DHEU (GERMIM DHE MBUSHJE).....	15
2.1	Hyrje.....	15
2.2	Gërmimi i Kanalit për shtrimin e tubacioneve	15
2.3	Mirembajtja e punimeve te gërmimit.....	16
2.4	Perforcimi i strukturave prane zones se gërmimeve.....	16
2.5	Heqja e materialeve te teperta gjate gërmimeve	16
2.6	Matja e volumeve te gërmimit.....	16
2.7	Analiza e cmimit njesi te punimeve te gërmimit	17
2.8	Mbushja dhe rrafshimi.....	17
2.9	Matja e volumeve te mbushjes	17
2.10	Analiza e cmimit njesi te punimeve te mbushjes	18
2.11	Mirembajtja e punimeve	18
3.	PUNIME BETONI, B/A, HEKURI, KALLEPE, etj.....	18
3.1	Te pergjithshme	18
3.2	Kontrolli i cilesise.....	19
3.3	Puna per gatitore dhe inspektimi.....	19
3.4	Materiale per betonin	20
3.5	Cimento.....	20
3.6	Inertet.....	21
3.7	Uji per beton.....	21
3.8	Transporti i betoneve.....	21
3.9	Hedhja dhe ngjeshja e betoneve	22
3.10	Betonim ne temperature te larta dhe kujdesi per betonet.....	23
3.11	Analiza e cmimeve te betonit	23
4.	SIGURIMI TEKNIK.....	24



1. TE PERGJITHSHME

1.1 Hyrje

Qellimi i pregatitjes se specifikimeve teknike eshte sqarimi dhe detajimi i kerkesave teknike ne lidhje me Projekt Zbatimin per realizimin e punimeve te ketij projekti:

- Artikujt e pergjithshem sic jane specifikuar,
- Planifikimin e punimeve,
- Pastrimin e vendit te punes, duke perfshire punime ndertimin, prishjeje dhe transporti,
- Sigurimin e burimeve te materialit dhe zonat e depozitimit,
- Punimet tokesore duke perfshire germimin dhe mbushje,
- Rregullimin e levizjeve te trafikut dhe te kerkesave te aksesit ne zonen e punimeve sipas masave te duhura,
- Zbatimi i te gjitha punimeve te ndertimit sic jane dhene ne vizatime dhe raporte

Ky raport paraqet detaje per realizimin e punimeve konform kushteve teknike te zbatimit, Legjislacionit ne fuqi per mbrojtjen e punonjesve, te ambientit dhe publikut si dhe detyrimeve te tjera qe duhen te plotesohen gjate zbatimit te punimeve.

1.2 Vendndodhja dhe hapesira e vendit te punimeve


Punimet jane paraqitur ne vizatimet teknike te projektit te detajuar bashkengjitur kontrates. Kontraktori duhet te analizoje thellesisht projektin dhe punimet qe do te kryhen, duke dale edhe ne terren per te vrojtuar vendin ku do te kryhen punimet dhe duke patur parasysh te gjitha kushtet dhe detajet per perfundimin e punimeve.

Pozicioni i pergjithshem i vendit te punes tregohet tek vizatimet/skicat.

1.3 Specifikimet

1.3.1 Specifikimet Nderkombetare

Disa specifikime dhe standarte te leshuara nga agjensite e njohura nderkombetare kane reference ne keto dokumenta te kontrates. Ata jane te perkufizuara dhe te perfshira ketu si Specifikime Nderkombetare dhe do te jene edicioni I fundit I cdo dokumenti te tille qe eshte ne



dispozicion 28 dite para dates se vendosur per paraqitjen e tenderit – derisa te shenohet ndryshe tek skica.

Duke ju referuar specifikimeve nderkombetare, jane perdorur shkurtimet e meposhtme:

S SH EN	Standarde Europiane te adoptuara si Standarde Shqiptare
AASHTO	Shoqeria amerikane e punonjesve te autostrades dhe transportit shtetedor
ASTM	Shoqeria amerikane per testim dhe materiale
BS	Standarti britanik

Kontraktuesi do te pajise dhe mirembaje zyren e tij tek vendi i punimeve me te pakten nje set te plote materialesh sic tregohen tek specifikimet e aprovuara. Ky set do te jete ne dispozicion per perdorim nga Mbikqyresi i punimeve.

1.3.2 Specifikimet Standarde


Specifikimet e mesiperme nderkombetare jane perfshire ne kontrate sebashku me pika te tjera dhe specifikime ne perdorim te rregullt. Sebashku me kerkesat tjera te ketij dokumenti, ata perbejne “Specifikimet Standarde” per qellimet e ketij projekti.

1.4 Njesite

Ne pergjithesi, dokumentet e kontrates dhe specifikimet teknike jane hartuar duke perdorur sistemin metrik nderkombetare (SI) te njesive. Aty ku standardet nderkombetare apo materialet tjera te referuara nuk jane shkruar duke perdorur metriken, njesite ekuivalenet imperiale apo vlerat mund te perdoren me aprovimin e Mbikqyresit te punimeve.

1.5 Zevendesimet

Zevendesimet e materialeve te specifikuara ne projekt do te behen vetem me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve dhe Investitorit. Keto zevendesime do te behen vetem ne se materiali i propozuar eshte me cilesi te njejta ose me te mira se materiali qe do te zevendesohet. Kerkesa me shkrim per zevendesimin e materialeve duhet te shoqerohet me dokumenta qe tregojne cilesine e materialit te propozuar dhe te dhenat teknike te dhena nga prodhuesi i ketij materiali.



Nuk do te njihet asnje pagese shtese apo ndryshim mbi cmimin njesi te dhene nga Sipermarresi ne Oferten e tij dhe te pasqyruar ne Preventivin e objektit qe shoqeron Kontraten.


1.6 Grafiku dhe metodologjia e punimeve

Sipermarresi duhet te paraqese komentet lidhur me metodologjine e propozuar ne projekt dhe te jape detaje te ndonje metodologjie te re ne varesi te teknologjise qe disponon apo planifikon te perdore per zbatimin e punimeve. Sipermarresi pas shqyrtimit te Projektit dhe Gjendjes Aktuale ne vend duhet te pregatite Grafikun e Punimeve dhe Metodologjine e Puneve sipas te cilave do te punoje per te plotesuar kerkesat e zbatimit te projektit ne kohen, sasine dhe cilesine e duhur.

Grafiku i Punimeve do te paraqese aktivitetet kryesore qe do te beje Sipermarresi per perfundimin me sukses te punimeve sipas kontrates.

Ne Grafikun dhe zberthimin e Metodes se punes duhet te perfshihen te pakten keto aktivitetet:

- Mobilizimi (Ngritja e kantierit)
- Ndertimi i rrugeve te sherbimit dhe hyrjes ne objekt.
- Investigimi topografik dhe piketimi i nenobjekteve
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve te Germimeve
- Aktivitetet e Punimeve te Betonit dhe B/A,
- Aktivitetet e Punimeve te ndryshme Ndertimore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilesise se materialeve
- Pregatitja e Librezave te masave
- Kolaudimi dhe marrja ne dorezim i objektit
- Pastrimi i sheshit te ndertimit
- Pregatitja e raporteve mujore dhe perfundimtare per punen e kryer
- Pregatitja e Vizatimeve te objekteve sic jane ndertuar



Keto aktivitete duhet te trajtohen per cdo nenobjekt. Pershkrimet dhe detajet e llogaritjeve te cilave jane dhene ne Raportin Teknik.

1.7 Mirembajtja e rruges dhe ndertimeve ekzistuese

Kontraktuesi do te mirembaje te gjitha rruget dhe ndertimet ekzistuese duke perfshire veprat e artit, nga fillimi i punimeve deri ne fund te kontrates. Siperfaqet e rruges se automjeteve, kanalet kulluese dhe ndertimet dhe cdo objekt brenda kufijeve te kontrates (qofte ekzistuese apo te rikonstruktura), do te mirembahen, do te pastrohen nga mbushjet, defektet e dukshme gjate periudhes se punimeve deri ne leshimin e certificates se perfundimit te punimeve. Kostot e kesaj mirembajtje do te perfshihen ne vlerat e kuotuar te punimeve.


1.8 Mobilizimi (Ngritja e kantierit)

Fillimi i punimeve do te konsiderohet dita kur Sipermarresi sjell pajisjet dhe makinerite e nevojshme per ngritjen e kantierit ku perfshihen ngrehinat e nevojshme per kryerjen e punimeve, zyrat e personelit, zyren e Mbikqyresit, te paisur edhe me te gjitha paisjet e nevojshme per realizimin e punimeve si, tavolina, karrike, dollape e rafte, kompjutera, ambjente sanitare, etj.

Dita (data) e fillimit te punimeve do te shoqerohet me nje process verbal te hartuar nga Sipermarresi dhe te firmosur nga Mbikqyresi I Punimeve, i cili njofton Investitorin me shkrim per fillimin e punimeve.

Sipermarresi do te mbaje pergjegjesi per cdo problem qe mund te ndodhe ne kantierin e ndertimit gjate te gjithe kohes se ndertimit te objektit. Sipermarresi eshte pergjegjes per sigurine, qendrushmerine si dhe kullimin e ujerave siperfaqesore ne kantierin e ndertimit.

Vlera per ndertimin e Kantierit, shesheve te depozitimit te materialeve dhe paisjeve, montim/cmontimin i nyjes se inerteve dhe betonierave/fabrikes se betonit, furnizimin me uje, etj., perfshihet ne cmimet njesi te punimeve te ndertimit. Ne kete pagese perfshihen te gjitha punimet qe mund te ndermerren gjate zbatimit te punimeve per mirembajtjen apo riparimet qe mund te dalin te nevojshme per t'u bere. Vlera e ketyre punimeve perfshihet ne vleren totale te investimit dhe nuk do te njihet ndonje shtese ne lidhje me kete ze.



1.9 Hyrja ne kantier dhe ne sheshin e ndertimit

Gjate te gjithë kohes se zbatimit te punimeve, Sipërmarresi duhet te organizoje punen per levizjen e njerezve/mjeteve ne sheshin e ndertimit. Kantieri i ndertimit duhet te rrethohet me rrjete teli. Sheshi i ndertimit duhet te jete i rrethuar me shirita plastike te pershtatshem qe njoftojne publikun per kryerjen e punimeve ne kete shesh. Sipërmarresi nuk duhet te lejoje hyrjen ne kantier / sheshin e ndertimit te personave qe nuk kane lidhje me ndertimin e objektit.

Trasimi i rrugeve hyrese ne objektet behet nga Sipërmarresi duke marre nje miratim paraprak nga autoritetet lokale. Sipërmarresi duhet te organizoje punen per ndertimin dhe mirembajtjen e rrugeve hyrese ne sheshin e ndertimit. Materiali per ndertimin e rruges do te merret ne depozitimet e inerteve te lejuara nga autoritetet lokale. Pas perfundimit te punimeve karierat sistemohen duke i dhene nje skarpate jo me pak se 1:1.5.

Vlera per ndertimin e Hyrjes ne kantier dhe Sheshet e Ndertimit, shesheve te depozitimit te materialeve dhe paisjeve, etj., perfshihet ne cmimet njesi te punimeve te ndertimit. Ne kete pagese perfshihen te gjithë punimet qe mund te ndermerren gjate zbatimit te punimeve per mirembajtjen apo riparimet qe mund te dalin te nevojshme per t'u bere. Vlera e ketyre punimeve perfshihet ne vleren totale te investimit dhe nuk do te njihet ndonje shtese ne lidhje me kete ze.


1.10 Furnizimi me uje gjate zbatimit te punimeve

Uji qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga burimi me i afert ne baze te legjislacionit perkates per shfrytezimin e burimeve ujore. Sipërmarresi do te shtriye rrjetin e vet te perkohshem te tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot perkatese ne lidhje me furnizimin me uje jane te perfshira ne vleren e punimeve dhe paguhen nga Sipërmarresi.

Ne rast se nuk ka mundesi lidhje me ndonje rrjet ekzistues Ujesjellesi, Sipërmarresi duhet te beje vete perpjekjet per furnizim me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per puntoret dhe punimet qe do te kryhen gjate zbatimit te projektit. Vlera e ketyre punimeve perfshihet ne vleren totale te investimit dhe nuk do te njihet ndonje shtese ne lidhje me kete ze.

1.11 Furnizimi me energji elektrike

Energjia Elektrike qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga Rrjeti kryesor elektrik nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundshme e cila do te caktohet nga filiali i OSHEE qe e ka ne perdorim linjen elektrike dhe do te jepet ne perdorim me ane te kontrates



perkatase. Ne rast se Lidhjet me rrjetin elektrik nuk jane te mundura, ose Sipermarresi e sheh te paleverdisshme, ai duhet te parashikojë vete një gjenarator ose burim tjetër alternativ energjie te mjaftueshem per te permbushur kërkesat per zbatimin ne kohe e me cilesi te punimeve. Kosto e energjise se nevojshme te energjise elektrike perfshihet ne koston totale te investimit dhe nuk do te njihet ndonje shtese ne lidhje me kete ze.

1.12 Moti i pafavorshem

Kontraktuesi do te pranojë si te vertete te gjithë risqet e vonesave ne perfundimin e punimeve qe mund te shkaktohen nga moti, duke perfshire (por pa u kufizuar nga):

- Renie shiu me te madhe se ajo e parashikuar qe ndalon, pengon ose vonon punimet.
- Periudha temperaturash me te uleta apo me te larta sesa temperaturat e parashikuara qe shkaktojne ngadalesim te punimeve.
- Ererat jashtezakonisht te forta dhe ndonje drejtim te paparashikueshem ere qe shkakton nderprerje te punimeve, demtim te pajisjeve, materialeve dhe mjeteve/godinave si dhe humbje kohe si pasoje e riparimeve ose zevenedesimeve te punimeve dhe pajisjes.

1.13 Transport i punonjesve


Kontraktuesi do te perfshije ne shumat e tij, te gjitha koston qe lidhen me transportin e stafit dhe punonjesve tek dhe nga pjese te ndryshme te punimeve. Kjo mendohet te perfshije cdo kosto qe mund te dale ne sigurimin, rekrutimin dhe pozicionimin e anetareve te forces se punes per punimet dhe te gjitha shpenzimet qe lidhen me mjetet e jeteses/ekzistencen.

1.14 Marrja ne dorezim

Punimet nuk do te merren ne dorezim ne seksione ose ne pjese. Punimet do te merren ne dorezim kur gjithë punimet te kene perfunduar ne te gjithë rrugen dhe elementet perberes te saj.

1.15 Piketimi dhe fotografimi i punimeve

Projekti shtrihet ne një zone prane rrjedhjes se ujerave te lumit ku eshte e mundshme qe relievi te pesoje ndryshime, natyrore apo artificiale.



Sipermarresi para se te fillojne punimet, ben verifikimet e relievit dhe gjendjen e objekteve ku shtrihet projekti. Perditesimi i gjendjes i behet i ditur Mbikqyresit duke i paraqitur vizatimet dhe ndryshimet perkatese te volumeve. Pas verifikimeve qe ben Mbikqyresi, ky perditesim i behet i ditur investitorit per te miratuar ndryshimet perkatese.

Sipermarresi, do te beje ndertimin dhe vendosjen e piketave dhe modinave sipas kerkesave te kushteve teknike te zbatimit dhe ne perputhje me informacionin e dhene nga Mbikqyresi. Sipermarresi do te jete pergjegjesi i vetem per cilesine dhe perpikmerine e vendosjes se tyre dhe matjeve ne terren. Ai do te marre masat per ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre nga demtimet qe mund te behen gjate zbatimit te punimeve dhe duhet te rivendose cdo pikete te demtuar.


Sipermarresi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik dhe ne mosperputhje me gjendjen aktuale.

Sipermarresi gjate te gjithë fazes se zbatimit te punimeve duhet te beje ne menyre periodike dhe te vazhdueshme, fotografime te punes sipas udhezimeve te Mbikqyresit ne menyre qe te demostroje progresin e punes, cilesine e materialeve te perdorura dhe punimeve te kryera, kushtet e punes, etj. Raportet mujore te ecurise se zbatimit te punimeve duhet te permbajne fotografite qe lidhen me punimet perkatese te permendura ne raport. Shpenzimet per fotografimet duhet te jene te parashikuara ne shpenzimet administrative te Sipermarresit dhe nuk do te njihet ndonje shtese ne lidhje me to.

1.16 Mbrojtja e punimeve, ambientit dhe publikut

Sipermarresi duhet te marre te gjitha masat e duhura paraprake per mbrojtjen e punetoreve, publikut si dhe pasurive ne dhe perreth sheshit te ndertimit konform ligjeve ne fuqi. Ai eshte pergjegjes i vetem per respektimin e masave te sigurimit teknik, kodeve te ndertesave dhe ndertimeve te tjera duke perfshire edhe ato arkeologjike, muzeale dhe historike. Sipermarresi duhet te beje sigurimin e jetes se punonjesve te tij, makinerive dhe punimeve prane njerës prej shoqerive te Sigurimit qe veprojne ne Shqiperi.

Gjate zbatimit te punimeve, Sipermarresi me shpenzimet e veta duhet te vendose dhe te mirembaje gjate nates pengesa te ndryshme dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidente te mundshme qe lidhen me keto punime. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtatshme, shenja me drita te kuqe "Rrezik" ose "Kujdes" si dhe vrojtues ne te



gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te levizjes normale te mjeteve ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

Sipermarresi, me shpenzimet e veta duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundshme per te siguruar ruajtjen e ambientit lokal nga ndotjet e ndryshme gjate punes, nga zhurmat, nga demtimet e pemeve, etj. Te gjitha makinerite dhe pajisjet qe do te operojne ne terren duhet te jene te pastra, te pershtatshme per transportin e materialeve pa shkaktuar derdhjen e tyre dhe konform rregullave dhe kushteve teknike te levizjes se tyre.


1.17 Tabela e Punimeve

Sipermarresi ne fillim te punimeve duhet te pregatite nje table metalike me permasat kryesore 2 x 1 m ku te jepen te dhenat Kryesore per emrin e objektit, vleren e tij, Fillimin dhe Perfundimin e Punimeve, Punedhenesin(Investitorin), Sipermarresin, Mbikqyresin e Punimeve, etj. Forma dhe Menyra e paraqitjes do te aprovohen nga Punedhenesi. Tabela e Punimeve duhet te vendoset ne bashkepunim me Mbikqyresin, ne nje vend te dukshem prane sheshit te ndertimit.

1.18 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i materialeve nga Sipermarresi duhet te behet me mjete transporti te pershtatshme te cilat kur te ngarkohen te mos shkaktojne derdhje te ngarkeses. Ngarkesa gjate transportit duhet te jete e siguruar sipas kushteve dhe rregullave ligjore te transportit te mallrave. Cdo makine qe nuk ploteson keto kerkesa apo rregullat e qarkullimit do te hiqet nga Kantieri dhe do te zevendesohet me nje mjet tjeter te pershtatshem. Te gjitha materialet qe do sjelle Sipermarresi ne objekt duhet te stivohen dhe te magazinohen ne menyre te pershtatshme per t'u mbrojtur nga kushtet atmosferike, rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet, etj. Ato duhet te vendosen ne menyre te tille qe te jene te kontrollueshme nga Mbikqyresi ne cdo kohe.

Sipermarresi duhet te siguroje me shpenzimet e veta nje vend te sigurt per magazinimin e te gjitha materialeve, ngritjen e magazinave dhe te zyrove te kantierit, zyren per Mbikqyresin e Punimeve, ne menyre te tille qe te jene te pershtatshme per kushte normale pune. Ne paragrafin e karierave jepe shpjegime lidhur me disatancen e transportit te materialeve nga kariera deri ne objekt.



1.19 Ditari i kantierit dhe Librezat e masave

Sipermarresi duhet qe ne fillim te punimeve te kete ditarin e objektit ne formen e nje libri me faqe te shenuara te njepasnjeshme dhe te firmosura e te vulosura nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi i punimeve. Ne kete ditar pervec shenimeve te perditeshme sic jane Moti, Reshjet, etj., duhet te permbaje te gjitha udhezimet apo shenimet qe lidhen me mbarevajtjen e punimeve te lena nga inspektore te ndryshem te punimeve, si Projektuesi, Investitori, etjere.


Sipermarresi para se te filloje punimet duhet te kete pregatitur vizatimet e punes te konfirmuara nga Mbikqyresi dhe pas mbarimit te cdo zeri te perditesohet me ndonje ndryshim te rastit qe do te mund te dale gjate zbatimit. Keto vizatime duhet te jene te shoqeruara me librezat perkatese te masave ku te jepen edhe te dhenat teknike per sasine dhe parametrat e tjere te materialeve te perdorura.

Sipermarresi duhet te pregatite edhe seksionet e profilat gjatesor e terthor te rishikuar si dhe te gjitha detajet e nevojshme te pajisur me shenimet perkatese qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate punimeve te germimit. Te gjitha vizatimet duhet te pregatiten ne CAD dhe do te jene pjese e dosjes se dorezimit te objektit. Te gjitha punimet e maskuara duhet te pasqyrohen ne librezat e masave dhe te jene pjese e dokumentacionit teknik qe do te dorezohet sebashku me Objektin.

Vizatime dhe librezat e masave do te azhornohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t'i dorezohen cdo muaj Mbikqyresit te punimeve per aprovim. Vizatimet e aprovuara do te mbeten prone e Punedhenesit dhe do te sherbejne per Kolaudimin dhe dorezimin e objektit.

1.20 Takimet progresive te punes

Sipermarresi do te marre pjese ne cdo takim mujor qe do te organizohet nga Mbikqyresi ne objekt ose ne zyren e tij per te diskutuar progresin e punimeve, problemet qe mund te kene dale gjate periudhes ne fjale, etj. Ne vecanti, Sipermarresi duhet te beje arranxhimet e duhura per takimet mujore ne terren si dhe nje shqyrtim te hollesishem te te shmangieve nga grafiku i punimeve te aprovuar, duke dhene shpjegimet e duhura per cdo shtyrje afati apo problem teknik qe mund te dale gjate zbatimit, perfshi edhe masat e sigurimit teknik te punonjesve. Takimet ne objekt do te perfshijne edhe inspektimin ne terren te punimeve te kryera se bashku me Mbikqyresin.



1.21 Standardet e zbatimit

Gjate zbatimit të punimeve duhet të respektohen të gjitha standartet teknike Shqiptare që janë në fuqi dhe në rastet kur nuk ka standarte për punime të vecanta, Sipërmarresi duhet të zbatojë standartet më të përparura që janë konform standarteve ISO ose EN. Këto standarte janë pjesë e Kushteve të Kontrates si dhe e Projekt Zbatimit të paraqitur.

1.22 Ndihma e shpejte

Sipërmarresi duhet të sigurojë dhe të mirëmbajë në objekt në vend lehtësisht të dallueshëm, të përcaktuar me parë një komplet të pajisjeve të ndihmes së shpejte të përcaktuar në legjislacionin përkatës Shqiptar. Këto pajisje duhet të jenë në një vend të pastër dhe me kushtet më optimale për hyrjen dhe qëndrimin në të gjatë të gjithë kohës së punës të punonjësve, Mbikqyresit dhe stafit përkatës. Sipërmarresi duhet të bëjë trajnimin përkatës të punonjësve për t'i instruktuar ata se si mund të jepen ndihma e shpejte. Një listë me numrat e telefonave më të nevojshëm duhet të jetë në dhomen e ndihmes së shpejte si dhe numrat e telefonit të spitalit më të afërm, doktorit të urgjencës, autoambulancës së zonës.


1.23 Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik

Gjate zbatimit të punimeve, Sipërmarresi duhet të zbatojë të gjithë rregullat e sigurimit teknik të kërkuara në kushtet e Kontrates dhe në Projektin e Zbatimit si dhe të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjet Shqiptare në fuqi. Mosrespektimi i këtyre rregullave do të jetë përgjegjësi e plotë e Sipërmarresit dhe Drejtuesit teknik të tij.

Gjithashtu, Sipërmarresi duhet të vendosë tabelë paralajmëruese për rreziqet që mund të jenë në objekt gjatë punës për të njoftuar njerezit e tjerë që mund të kalojnë pranë objektit. Gjatë punimeve (me rrezikshmeri të rënies së gureve), germimeve apo punime elektrike, duhet të zbatohen rregullat përkatëse të sigurimit teknik për këto lloje punimesh speciale të përfshira në legjislacionin Shqiptar.

1.24 Karrierat e materialeve inerte dhe gureve

Kontraktuesi duhet të ndertojë me shpenzimet e tij të gjitha rrugët e perkoheshme apo të përhershme, që do të përdoren për sjelljen e materialeve nga karrierat. Kur këto rrugë furnizimi mund të përdoren nga të tjerë, Kontraktuesi nuk duhet të lejojë që këto rrugë të prishen, për shkak të veprimtarisë së tij.



Kontraktuesi duhet të marrë masat e veta për përdorimin e të gjitha rrugëve jo-publike të furnizimit, të cilat prekin pronat e të tjerëve. Çdo shpenzim për përdorimin e këtyre rrugëve të furnizimit të përfshihet në përgjegjësinë e Kontraktuesit.

1.24.1 Karriera e inerteve për prodhimin e betoneve

Betonet parashikohen të prodhohen në vend duke shfrytëzuar materialet inerte që gjenden në zonën që rrethon sheshin e ndërtimit. Në këto kushte, kryerja e punimeve do të kërkojë ndërtimin e nryjeve të prodhimit të inerteve betonit të cilat mund të ndërtohen në afërsi ose si pjesë përbërëse e kështjrit.

1.25 Çmontimi i kështjrit

Më mbarimin e kontratës dhe pas marrjes së aprovimit më shkrim nga investitori I projektit, kontraktuesi do të largojë (çmontojë) dhe të heqë të gjithë ndërtimet e perkohshme, makinerite, si dhe do të bëjë planin për shkeputjen e furnizimit më ujë dhe elektricitet, heqjen e shërbimeve të perkohshme të kullimit dhe do të pastrojë kanalet dhe gropat septike. Kjo përjashton artikujt dhe shërbimet të cilat kërkohen të rikthehen në pronesi investitorit. Kontraktuesi do të riparojë çdo dëmtim të kështjrit, pastroje dhe të heqë nga sheshi më shpenzimet e tij të gjitha impiantet ndërtimore, makinerite, pajisjet speciale, materialet ndërtimore që kanë tēpruar, mbeturinat e ndryshme, skelerite, etj.


1.26 Azhornimi pērfundimtar, Dorezimi dhe Kolaudimi i punimeve

Më pērfundimin e punimeve, Sipërmarrësi krijon dosjen e dokumentacionit përkatës të hartuar gjatë zbatimit të punimeve dhe paraqet në Autocad të gjithë vizatimet e objekteve siç janë ndërtuar (të azhornuar).

Dorezimi i objektit tek Mbikqyresia nënkupton pērfundimin e plote të punimeve, provave që konfirmojnë cilësinë e pranueshme të punimeve dhe plotesimin e dosjes së plote sipas legjisllacionit në fuqi për marrjen në dorezim dhe kolaudimin e objekteve të ndërtimit.

Sipërmarrësi njofton më shkrim Mbikqyresinë se punimet kanë pērfunduar, duke dorezuar dosjen e dokumentave dhe raportin pērfundimtar të Sipërmarrësit (pjesë e dosjes së dorezimit) dhe i kërkon Mbikqyresit datat e kontrollit dhe të kolaudimit të objekteve.

Dosja miratohet fillimisht nga Mbikqyresia, i cili harton një raport dorezimi më përshkrimet standarte dhe analizat që kërkon ligji përkatës për dorezimin dhe kolaudimin e objekteve. Ky



raport ben pjese ne dosje. Mbikqyresi njofton me shkrim investitorin per gadishmerine e fillimit te procesit te kolaudimit te punimeve.

Sipermarresi duhet t'u pergjigjet ne kohe e me cilesi te gjitha kerkesave qe do te kene

2. PUNIME DHEU (GERMIM DHE MBUSHJE)

2.1 Hyrje


Qellimi i pregatitjes se ketij kapitulli eshte sqarimi i kerkesave teknike ne lidhje me Punimet e Dheut qe do te kryhen prej tij. Keto kerkesa do te jene ne lidhje me germimin, hapjen e kanaleve, shtresezimin e rrugeve, mbushjen e skarpatave, duke patur paraysh edhe makinerite qe do te perdoren per keto punime si dhe kushtet teknike te zbatimit, Legjislacionin ne fuqi per mbrojtjen e Punonjesve, te ambientit dhe publikut si dhe detyrimeve qe duhet te plotesoje Sipermarresi gjate zbatimit te punimeve.

2.2 Gërmimi i Kanalit për shtrimin e tubacioneve

Në fillim të çdo procesi gërmimi do të bëhet njëhere pastrimi i sheshit. E gjithë zona ku do të gërmohet, do të pastrohen nga të gjitha shkurret, rrënjët e mëdha, mbetjet dhe materialet e tjera sipërfaqesore. Të gjitha këto materiale do të spostohen dhe largohen na zona me mjete transportuese.

Kanali do të gërmohet në dimensionet dhe nivelet e treguara në vizatime dhe/ose në përputhje me instruksionet me shkrim të Mbikqyrësit të Punimeve. Zëri i treguar në tabelën e Volumeve (Preventiv) lidhur me gërmimet, siç është largimi i materialit të gërmuar do të përfshijë çdo lloj kategorie dheu, nëse nuk do të jetë specifikuar. Gërmimi me krahë është gjithashtu i nevojshëm në afërsi të intersektimeve me infrastrukturën e tjera për të parandaluar dëmtimin e tyre. Me përjashtim të vendeve të përmendura më sipër, mund të përdoren makineritë.

Thellimet për pjesët lidhëse do të gërmohen me dorë mbasi fundi i kanalit duhet të jetë i niveluar. Kanali për tubacionet do të gërmohet nën nivelin e pjesës së poshtme të tubacionit siç tregohet në vizatime, për të bërë të mundur realizimin e shtratit të tubacioneve me material të granular. Më pas në kanalin e gërmuar do të shtrihen tubacionet me dimensionin përkatës sipas kuotave dhe drejtimit të përcaktuara në vizatimet e projektit.



2.3 Mirembajtja e punimeve te germimit

Te gjitha punimet e germimit do te mirembahen sic duhet nderkohe qe ato jane te hapura dhe te ekspozuara, si gjate dites ashtu edhe gjate nates. Pengesa te mjaftueshme, drita paralajmeruese, shenja si dhe mjete te ngjashme do te sigurohen nga Sipermarresi. Sipermarresi do te jete pergjegjes per ndonje demtim personi ose pronesie per shkak te neglizhences se tij ose mos marrjes se masave te duhura te Sigurimit Teknik.

2.4 Perforcimi i strukturave prane zones se germimeve

Si pjese e punes ne zerat e germimit, Sipermarresi do te perforcoje te gjitha ndertimet, muret si dhe strukturat e tjera, qendrueshmeria e te cilave duhet te garantoje mosrrezikimin gjate zbatimit te punimeve dhe do te jete teresisht pergjegjes per te gjitha demtimet e personave ose te pasurive qe do te rezultojne nga aksidentet e ndonje prej ketyre ndertimeve apo strukturave perkatese

Ne se ndonje prej ketyre strukturave, instalimeve apo sherbimeve do te rrezikohen apo demtohen si rezultat i veprimeve te Sipermarresit, ai duhet te lajmeroje menjehere Mbikqyresin e Punimeve si dhe autoritetet qe kane lidhje me te dhe menjehere te marre masa per ndreqjen e demit qe eshte bere.


2.5 Heqja e materialeve te teperta gjate germimeve

I gjithë materiali i tepert i germuar do te largohet ne vendet e aprovuara nga Mbikqyresi. Kur eshte e nevojshme te transportohet materiali mbi rruget ose ne vendet e shtruara duhet te sigurohet ky material nga derdhja ne rruge ose ne vendet e caktuara. Meqenese nje pjese e materialit te germuar do te perdoret per realizimin e mbushjeve me dhe te ngjeshur, materiali i germuar seleksionohet paraprakisht dhe ajo pjese e materialit qe do te riperdoret depozitohet me miratim te Mbikqyresit te punimeve.

2.6 Matja e volumeve te germimit

Te gjitha zerat e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumeve te germimit do te bazohet ne dimensionet e marra ne vizatimet ne te cilat percaktohen permasat e germimeve, ne prezence te Mbikqyresit te punimeve.

Cdo germim pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime, nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Mbikqyresi.



2.7 Analiza e cmimit njesi te punimeve te germimit

Cmimi njesi i zerave te punes per germimet do te perfshijne germimin me cdo mjet qe te jete i nevojshem, duke perfshire germime me dore, apo me makineri, nen apo mbi nivelin e ujrave nentokesore, duke perfshire perzierje dhe te cdo lloji, largimin dhe grumbullimin e bimesive apo pemeve te hequra, marrja e masave mbrojtese, sigurimin teknik, realizimi i matjeve, furnizimi dhe transporti i fuqise punetore.

2.8 Mbushja dhe rrafshimi

Punimet mbushëse dhe rrafshuese do të realizohen në përputhje me përmasat dhe nivelet që tregohen në vizatime. Materialet që do të përdoren për punimet mbushëse do të jenë të lira nga gurët dhe pjesët e forta më të mëdha se 75 mm në çdo përmasë, dhe gjithashtu të pastër nga përbërës druri apo mbeturina të çdo lloji. Materiali mbushës do të ngjishet sipas mënyrës së aprovuar.


Nëse nuk specifikohet apo kërkohet ndryshe nga Mbikqyrësi i Punimeve, materiali mbushës dhe mbulues do të merret nga punimet e gërmimeve. Nëse Mbikqyrësi i Punimeve përcakton se materiali nuk është i cilësisë së duhur atëherë do të përdoret material i zgjedhur i sjellë nga një zonë tjetër. Materiali i zgjedhur do të jetë homogjen dhe do t'i kushtohet rëndësi pastrimit nga llumrat, rrënjët e bimëve dhe çdo mbetjeje tjetër.

Mbushjet dhe rrafshimet do të jenë në shtresëzime të vazhdueshme dhe gati horizontale për të arritur trashësinë e treguar në vizatime ose siç mund të kushtëzohet nga Mbikqyrësi i Punimeve. Shtresa e sipërme e mbushjes dhe e mbulimit duhet të mbahet në gjendje sa më të sheshtë të jetë e mundur.

2.9 Matja e volumeve te mbushjes

Te gjithë zerat e mbushjeve me dhe te ngjeshur do te maten ne volum te punes se perfunduar. Matja e volumeve te mbushjeve do te bazohet ne dimensionet e marra ne vizatimet ne te cilet percaktohen permasat e mbushjeve, ne prezence te Mbikqyresit te punimeve

Cdo mbushje pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime, nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Mbikqyresi.



2.10 Analiza e cmimit njesi te punimeve te mbushjes

Cmimi njesi i zerave te punes per mbushje me dhe te ngjeshur do te perfshijne mbushjen me cdo mjet qe te jete i nevojshem, duke perfshire mbushje dhe ngjeshje me makineri apo ne pjese te vecanta ku nuk mund te nderhyet me makineri, ngjeshje me tokmak, nen apo mbi nivelin e ujrave nentokesore, perfshire perzierje dheu te cdo lloji, largimin dhe grumbullimin e materialeve te dobeta, furnizimi dhe transporti i fuqise puntore.

2.11 Mirembajtja e punimeve

Ndersa ndertimi eshte ne vazhdim, gjate gjithë kohes duhet te mirembahen punimet e mbushjes. Kontraktuesi duhet mirembaje te gjitha punimet e mbushje germimit (dhe jo vetem) gjate kohezgjatjes se Kontrates dhe duhet te marre te gjitha masat e duhura paraprake per te parandaluar humbjen e materialit nga skarpata e diges, per shkak te veprimit te eres apo ujit.

Ai duhet te riparoje me shpenzimet e tij, pervec nese ne keto specifika parashikohet ndryshe, cdo rreshqitje toke, gerryerje, cedim dheu, ulje apo probleme te tjera qe mund te paraqiten perpara perfundimi te punimeve.

Propozimet e Kontraktuesit per mbrojtjen e punimeve te kryera nen kete Kontrate nga demtimi si pasoje e permbytjes apo per shkaqe te tjera gjate punimeve te tij per ndertimin e strukturave shoqeruese, duhet t'i parashtrohen Mbikqyresit te punimeve per miratim. Ky parashtrim dhe miratimi i tij, ne asnje menyre nuk duhet te çliroje Kontraktuesin nga pergjegjesia per cdo dem qe mund te ndodhe si pasoje e ketyre punimeve.


3. PUNIME BETONI, B/A, HEKURI, KALLEPE, etj.

Betonet qe do te perdoren ne objektet e kesaj kontrate jane betone te zakonshem konform standarteve ne fuqi. Betonet jane parashikuar te prodhohen ne vend.

Ne fillim te zbatimit te punimeve, Sipermarresi duhet te paraqese tek Mbikqyresi propozimin e tij per organizimin e aktiviteteteve te prodhimit te betonit, i cili duhet te permbaje:

3.1 Te pergjithshme

Qellimi i puneve qe perfshin ky kapitull eshte zbatimi i procesit te betonimit konform standarteve, kushteve teknike dhe kerkesave te projektit gjate ndertimit te nenobjekteve.



Kryerja e këtij procesi duhet të bëhet me makineri perkatese (perzieres betoni, transportues betoni, vibrator mekanik, etj), veglat e punes, materiale dhe pajisje të tjera speciale (pompa, pajisje topografike, etj) që janë të domosdoshme për perfundimin në sasinë dhe cilësinë e duhur të këtij procesi.

Në fillim të zbatimit të punimeve, Sipermarresi duhet të paraqesë tek Mbikqyesi propozimin e tij për organizimin e aktiviteteve të prodhimit të inerteve, prodhimit të betonit dhe betonimit në shesh i cili duhet të përmbajë:

- Kapacitetin e nyjes së prodhimit të inerteve, nyjes së prodhimit të betonit, parkun e makinerive që do të transportojnë materialet për prodhimin dhe transportin e betoneve, numri i tyre për të përballuar volumnin e parashikuar në preventiv brenda kohës së realizimit të punimeve.
- Shesh depozitimet e materialeve inerte dhe cimentos
- Vendosjen dhe shtrirjen e pajisjeve të prodhimit të betonit
- Metodatat e propozuara për organizimin e pajisjeve të prodhimit të betonit
- Procedurat e kontrollit të cilësive të betonit dhe materialeve të betonit
- Furnizimin me ujë dhe energji elektrike
- Kapacitetet e makinerive që do të transportojnë betonin në veper, numri i tyre për të përballuar volumnin e parashikuar në preventiv brenda kohës së realizimit të punimeve.
- Detaje të punës së bërjes së kallepeve duke përfshirë kohën e heqjes së kallepeve dhe procedurat për mbështetjen e perkohshme.

3.2 Kontrolli i cilësive


Materialet dhe mjështeria e përdorur në punimet e betonit duhet të jetë e një cilësie sa më të lartë që të jetë e mundur. Kontrolli i cilësive do të bëhet konform Kushteve Teknike të Zbatimit dhe standarteve perkatese në prezencë të Inxhinierit dhe Mbikqyresit të Punimeve të cilët do të jenë edhe përgjegjës për cilësinë e betoneve të hedhura në veper.

3.3 Puna përgatitore dhe inspektimi

Përpara se të kryhet procesi i përgatitjes së betonit, zona brenda armaturave duhet të jetë e pastruar shumë mirë me ujë ose me ajër të komprimuar. Asnjë proces betonimi nuk duhet të

ENGINEERING CONSULTING GROUP

HEAD OFFICE - TIRANË; [Mob: +355 69 40 98 814](tel:+355694098814) NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tirane; e-mail: ecgroup20@gmail.com



kryhet derisa Mbikqyresi te kete inspektuar dhe aprovuar betonimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim te betonit, fugat e ndertimit, fugat e temperatures, fiksimin e fundeve, armimin, te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi.

3.4 Materiale per betonin

Sipermarresi para fillimit te punimeve te betonit duhet te dergoje kampione te materialeve inerte dhe cimentoje ne laboratore te licensuar per testimin e materieleve te ndertimit dhe te kerkoje nxjerrejn e receptuarave te betonit ku perfshihen sasite e materialeve inerte, rere, granile dhe raportin Uje / Cimento per te gjithë llojet e betoneve te parashikuara ne projekt. Sasite e materieleve apo raportet e cituara me poshte jane vetem orientuese.

Formula e betonit do te hartohet sipas SSH-EN 206 – 1

3.5 Cimento


Nje nder materialet me te rendesishem qe perdoren per betonet dhe qe duhet t'i nenshtrohet kontrollit teknik te Mbikqyresit eshte cimento.

Sipermarresi duhet te beje nje test lidhur me agresivitetin e ujit para fillimit te betonimit. Kjo certifikate i dorezohet Mbikqyresit para fillimit te punimeve.

Cimento duhet te shperndahet ne paketa orgjinale te shenuara, te pademtuara, direkt nga fabrika dhe te ruajtura ne kushtet e duhura ne nje depo te pershtatshme dhe te ajrosur. Thaset e cimentos duhet te jene te vendosur te pakten 15 cm mbi siperfaqen e tokes. Cimento nuk duhet te qendroje me shume se tre muaj ne kantier pa lejen e Mbikqyresit. Cdo lloj cimento e ngurtesuar apo e demtuar nuk duhet te perdoret. Cdo dergese e Cimentos duhet te jete e shoqeruar me certifikaten e cilesise dhe flete analizat perkatese te fabrikes prodhuese. Cimento e perftuar nga pastrimi i thaseve te cimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret.

Testimi i cimentos do te behet me standardin SSH EN 196-1 dhe duhet te plotesoje kerkesat e standardit SSH EN 197-1.

Mbikqyresi ka te drejte te kerkoje ritestimin e cimentos kur ka dyshime mbi cilesine e saj apo gjendjen aktuale.



3.6 Inertet

Inertet per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar SSH-EN-12620 ose ne perputhje me Standarde te tjera ne fuqi sic aprovohet nga Mbikqyresi i punimeve.

Ato duhet te jene te paster, te forte, te qendrueshem, dhe nuk duhet te permbajne lende organike ose masa te tjera te demshme qe veprojne kunder fortesise dhe qendrueshmerise se betonit apo te betonarmes.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet e njohura dhe te licensuara qe sigurojne rezultate te kenaqshme per te gjitha llojet e betoneve. Materiali i marre ne kariera te palicensuara duhet te verifikohet paraprakisht ne laboratore te licensuar nese eshte I pershtatshem per prodhim betoni.

Inertet e perdorura do te jene te imta dhe te trasha. Ato do te perdoren se bashku ne betonet sipas nje sasie e raporti te dhene ne Kushtet Teknike perkatese, analizat paraprake laboratorike per recepturat dhe me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve.

3.7 Uji per beton


Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte e llumra, pa papasterti organike vegjetale dhe pa kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovohet nga Mbikqyresi i punimeve. Nuk duhet te perdoret uje nga gropat e germimeve, kullimet sipërfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cilesore duhet te perdoret per larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.

Uji do te testohet ne perputhje me standardin SSH EN 1008

3.8 Transporti i betoneve

Betoni duhet te transportohet nga vendi i pregatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt te jete e mundur ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kur te jete e mundshme, betoni do te derdhet nga perzieresi direkt ne nje paisje qe do te beje transportimin e betonit ne destinacionin perfundimtar duke shmangur shperndarjen, fraksionimin ose derdhjen e tij.



Nese Sipermarresi propozon te perdore pompa per transportin dhe vendosjen e betonit ai duhet te paraqese tek Mbikqyresi i Punimeve, detaje te plota per pajisjet dhe tekniken e perdorimit te pompes dhe paisjeve qe ai propozon per te perdorur.

Ne rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompe, kantieri qe do te perdoret duhet te projektohet per te siguruar rrjedhjen e vazhdueshme dhe te panderprere ne rrepire ose ne gryke (hinke). Fundi i pjerrtise ose i pompes se shperndarjes duhet te jete i mbushur me uje para dhe pas cdo periudhe pune dhe duhet te mbahet i paster. Uji i perdorur per kete qellim duhet te largohet nga cdo ambient pune te perhershme.

3.9 Hedhja dhe ngjeshja e betoneve

Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer procesin e hedhjes dhe ngjeshjes se betonit si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te ciles duhet te jete prodhimi i nje betoni te papershkueshem nga uji me nje densitet dhe fortesi maksimale


Pasi te jete perziere, betoni duhet te transportohet ne vendin e punes sa me shpejt te jete e mundur, te ngjishet mire deri sa te krijoje siperfaqe te lemuara, pa vrima dhe pa xhepa ajri. Armatura duhet te jete e hapur ne menyre qe te lejoje daljen e bulezave te ajrit dhe betoni duhet te vibrohet me cdo kusht me mjete vibruese per ta bere sa me te dendur dhe aty ku eshte e nevojshme. Mjetet vibruese duhet te prodhojne vibrime jo me pak se 5000 cikle ne minute. Vibratorët duhet te vendosen vertikalisht ne beton dhe te terhiqen gradualisht deri sa fluckat e ajrit nuk dalin me ne siperfaqe.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe ngjeshjes se betonit duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjestaret perkates te ekipit te punes.

Betoni duhet te hidhet sa eshte i fresket dhe para se te kete fituar qendrueshmerine fillestare por gjithmone jo me vone se 30 minuta pas perzierjes.

Kur hedhja e betonit nderpritet, masa e betonit duhet te kete forme te pershtatshme per nje bashkim konstruktiv efikas qe percaktohet ne vend sipas rastit. Para se te hidhet betoni tjetër, siperfaqet e te gjitha fugave duhet te kontrollohen, te pastrohen me furce metalike dhe te lahen.

Para se betoni te hidhet ne nje siperfaqe te germuar, ky germim duhet te jete i forcuar dhe pa uje te rrjedhshem apo te ndenjor, vaj apo lende te tjera te demshme



3.10 Betonim ne temperature te larta dhe kujdesi per betonet

Sipermarresi duhet te tregojë kujdes gjate motit te nxehte per te parandaluar carjen apo plasaritjen e betonit. Do te ishte mire qe betoni te hidhet ne mengjes ose naten vone. Kallepet duhet te mbulohen nga ekspozimi direkt ne diell si para vendosjes se betonit ashtu edhe gjate hedhjes dhe ne vazhdim.

Sa i takon kohezgjatjes se kujdesit per te gjitha betonet rekomandohet qe per:

- Siperfaqe betoni horizontale mbahen te laget vazhdimisht per te pakten 7 dite pas hedhjes. Ato mbulohen me materiale ujembajtes si thase kerpi, pelhure ose menyra te tjera te aprovuara nga Mbikqyresi
- Siperfaqe betoni vertikale, fillimisht lihet armatura ne vend pa levizur por duke e mbajtur vazhdimisht te laget per te pakten 7 dite pas hedhjes. Ato mbulohen me materiale ujembajtes si thase kerpi, pelhure, e tjere.

3.11 Analiza e cmimeve te betonit

Cmimi njesi per nje meter kub beton i derdhur mbulon puntorine, furnizimin e inerteve, cimentos, ujit dhe shtesave speciale, polisterolin e fugave si dhe, perzierjen, hedhjen dhe ngjeshjen ne cdo seksion apo trashesi betoni. Ne kete cmim do te futet edhe kujdesi per betonin, materiali per realizimin e fugave te temperatures, provat dhe te gjitha aktivitetet e tjera qe duhen per ekzekutimin e punimeve me cilesi.

Mbushja e bashkimeve me material izolues, vendosja e armimit ku te jete e nevojshme, armaturat dhe fuqia punetore e nevojshme jane te perfshire ne cmimin njesi te betoneve. Cdo volum betoni pertej limiteve te treguara ne vizatime nuk do te paguhet.

Transporti i betoneve nga nyja ne objekt do te behet me autobetoniere dhe jepet e perfshire ne cmimin njesi.

Megjithate perpos ketyre specifikimeve duhet te kontrollohet analiza teknike e zerave te punes, sipas Preventivit te Punimeve.


4. SIGURIMI TEKNIK

Jane te detyrueshme dhe punonjesit duhet ti nenshtrohen ketyre specifikimeve dhe ti permbahen ne menyre te rrepte te procedurave te parashikuara. Mos permbajtja ose mos zbatimi i cdo termi i cdo procedure te sigurimit teknik dhe shendetit detyron ndeshkimin e punonjesit sipas denimeve qe parashikon ne Regulloren e Brendshme te Shoqerise dhe arrijne sipas rendesise se shkeljes se termave ne penalitetin e perjashtimit.

4.1 Te detyrueshme per perdorim

- Perdorimi i kaskes mbrojtese ne pune eshte i detyrueshem
- Perdorimi i kepuceve te sigurimit kunder rreshqitjes jane te detyrueshme perdorja e tyre gjate proceseve te punes
- Perdorimi i rripave te sigurimit eshte i detyrueshem kur kryhen punime ne lartesi.
- Perdorimi i jelekve fosforeshent eshte po ashtu shume e rendesishme gjate proceseve te punes, sidomos gjate punes ne oret e nates.
- Perdorimi i dorezave eshte i detyrueshem per punonjesit gjate proceseve te punes me hekur dhe beton qe te mos kene kontakt te drejtperdrejte fizik.





- Perdorimi i kufjeve ne raste se gjate proceseve te punes ka zhurme sepse mund te shkaktoje demtime ne degjim.
- Uniforma e punes sic jane kombinoshet jane te rendesishme sepse bejne dallimin e punonjesve ne kanter nga njerez qe mund te jene kalimtar te rastit,eshte e rendesishme dhe e detyrueshme per punonjesit te kene nje uniform te caktuar.

